



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim
dymujor
Viti VII
Nr.45
Nëntor -
Dhjetor
2010

Takimi mes Drejtorëve të Departamenteve Ligjore të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive me Kryesuesit e Kolegjiemeve të AKK-së



Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e dytë të përbashkët mes drejtorëve të Departamenteve Ligjore të Zyrës së Kryeministrit/ të Ministrive dhe Kryesuesve të Kolegjiemeve të AKK-së. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mes zyrtarëve nga niveli qendror dhe zyrtarëve nga niveli lokal për Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe për mënyrën e efikasitetit për zbatimin e legjislacionit që mbulon fushat që janë në përgjegjësi të Komunave. Në këtë takim morën pjesë drejtori i zyrës ligjore të Zyrës së Kryeministrit, Drejtorët e Departamenteve Ligjore të Ministrive të Linjës, Kryesuesit e Kolegjiemeve të AKK-së dhe zyrtarët e AKK-së.

AKK-ja publikoi pesë Deklarata Parimore për pushtetin lokal



Qeveritë Lokale në Evropën Juglindore kërkojnë rol më të madh në procesin e pranimit në BE

Presidentja e Komitetit të Rajoneve znj. Mercedes Bresso u takua me Presidentin e Rrjetit të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) Vladimir Moskov për të përforcuar rolin e autoriteteve lokale në procesin e pranimit në BE. Ata bënë thirrje për Komisionin Evropian për t'i njohur qeveritë lokale si aktorët kryesor në programimin dhe shfrytëzimin e fondeve të para-pranimit në BE (IPA), sidomos në prag të ciklit të ardhshëm të IPA programimit për periudhën 2013-2018 dhe më gjërë.



Komunat e Kosovës ndihmojnë Shqipërinë me ushqime bagëtish

Komunat e Kosovës kanë filluar aksionin për mbledhjen e ushqimeve për bagëti për t'i dërguar në Shqipëri në zonat e prekura nga vërshimet. Duke marrë parasysh situatën e vështirë që e ka kapluar Shqipërinë pas vërshimeve të fundit dhe mungesës së theksuar të ushqimit për bagëtinë atje, atje kanë filluar të ngordhin bagëtitë në Shqipëri në mungesë të ushqimit. Angazhimi i komunave për organizimin e këtyre ndihmave erdhi pas bashkëpunimit të mirë që ka Asociacioni i Komunave të Kosovës me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë.



Zëvendëskryeministri i Shqipërisë takohet me anëtarët e AKK-së



Zëvendëskryeministri dhe njëkohësisht ministër i Energjetikës, Meta, së bashku me ministrin e Bujqësisë, Genc Ruli, me rastin e vizitës Gjakovës, me qëllim të falënderimit nga aty popullin e Kosovës, i cili edhe këtë herë ka ndihmuar shqiptarët pas vërshimeve të javëve të fundit në zonën e Shkodrës. Në këtë takim kanë marrë pjesë kryetarët e komunave të Ferizajt, Prizrenit, Deçanit dhe Junikut. Kryetari Pal Lekaj, tha se "ne çdo herë kemi qenë afër Shqipërisë, sikurse Shqipëria ka qenë afër Kosovës. Ne tani jemi munduar që në mënyrë simbolike të jemi afër qytetarëve të Shkodrës. Këtë e bëjmë me kënaqësi dhe ndihemi mirë për këtë, sepse jemi një komb", ka thënë Lekaj. Ndërsa kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, njëherësh kryetar i Ferizajt, z.Bajrush Xhemajli ka falënderuar zëvendëskryeministrin Meta për ndihmën që Shqipëria i ka dhënë dhe po i jep Kosovës.

Asociacioni i Komunave të Kosovës si anëtar i Komitetit Drejtues është duke lobuar për komunat në 'Programin e infrastrukturës socio-ekonomike komunale' të financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) nga fondet e IPA 2007 dhe implementuar nga Louis Berger SAS. Në takimin e fundit të Komitetit Drejtues të këtij programi, të mbajtur me 13 dhjetor 2010 në MAPL, janë paraqitur disa vërejtje dhe shqetësime nga ZNKE të cilat kërkojnë vëmendjen e komunave. Impjantet të cilat janë duke

Programi i infrastrukturës socio-ekonomike komunale / IPA 2007

u ndërtuar në Komunat e Kosovës përkatëse kërkojnë një menaxhim të mirëfilltë, prandaj ZNKE kërkon nga komunat që të caktojnë operatorët dhe stafin i cili duhet të trajnohet për mirëmbajtjen e impianteve pas përfundimit të projektit. Në këtë takim janë diskutuar edhe mundësitë e bashkëpunimit mes Komunave dhe Kompanive të ujësjellësit si operatorë të mundshëm. AKK ka kërkuar nga

ZKNE dhe Louis Berger SAS të paraqesin disa modele të mundshme për mirëmbajtjen e impianteve nga operatorët potencial, modele të cilat do të prezantohen para prillit 2011. ZNKE në bashkëpunim me MAPL planifikon të organizojë një takim me Kryetarët e Komunave dhe ndërmarrjet publike përkatëse në janar 2011 për të diskutuar mundësitë e zgjidhjes së këtyre problemeve.


AKK-ja nxori PESË Deklarata Parimore për pushtetin lokal

Asociacioni i Komunave të Kosovës përmes Kolegjiumeve të veta profesionale, në muajin nëntor, përgatiti dhe publikoi pesë Deklarata Parimore mbi qeverisjen lokale (Deklarata Parimore për Arsim, Financa Lokale, Shërbime Sociale, Urbanizëm dhe Zhvillim Ekonomik Lokal).

“Kosova ka nevojë për qeverisje të fortë lokale. Politikat për zhvillimin e Kosovës mund të kenë sukses duke përfshirë dhe informuar nivelin lokal. Asociacioni i Komunave të Kosovës ka një rol të rëndësishëm për të ndihmuar

Këto dokumente të rëndësishme të AKK-së përcaktojnë problematikën në sferën e qeverisjes lokale në atë fushë dhe jep rekomandimet se si të gjendet zgjedhja më e mirë e mundshme e zbatueshme.

Qeverinë, për të ofruar qeverisje të mirë dhe gjithashtu për të informuar Qeverinë rreth shqetësimeve dhe vështirësive të komunave” – thotë kryetari i AKK-së z.Bajrush Xhemaili në parathënie të këtyre publikimeve të rëndësishme të AKK-së. Qëllimi i këtyre deklaratave është që të afirmojë përgjegjësitë e komunave, të garantuara me Kushtetutë dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Pozita e tyre fuqizohet më tej nëpërmjet Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale e cila i jep një mandat të fortë nivelit të qeverisjes lokale në të gjithë Evropën. Këto Deklarata Parimore janë përgatitur nga anëtarët e Kolegjiumeve përkatëse edhe me ndihmën e ekspertëve të fushave përkatëse.



Historia e përshkrimit të problemeve komunale në sektorë të ndryshëm përmes Deklaratave Parimore daton nga viti 2004 kur atëherë AKK-ja kishte nxjerr po ashtu 13 Deklarata Parimore mbi qeverisjen lokale shoqëruar edhe Udhëzuesit e Implementimit.

Takimi mes Drejtorëve të Departamenteve Ligjore të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive me Kryesuesit e Kolegjiemeve të AKK-së

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e dytë të përbashkët mes drejtorëve të Departamenteve Ligjore të Zyrës së Kryeministrit/ të Ministrive të Linjës dhe Kryesuesve të Kolegjiemeve të AKK-së. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mes zyrtarëve nga niveli qendror dhe zyrtarëve nga niveli lokal për Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe për mënyrën e efikasitetit për zbatimin e legjislacionit që mbulon fushat që janë në përgjegjësi të Komunave. Në këtë takim morën pjesë drejtori i zyrës ligjore të Zyrës së Kryeministrit, Drejtorët e Departamenteve Ligjore të Ministrive të Linjës, Kryesuesit e Kolegjiemeve të AKK-së dhe zyrtarët e AKK-së.

Drejtori **Sazan Ibrahim** – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së, hapi takimin me fjalë përshëndetëse dhe falënderuese për pjesëmarrje dhe prezenti në pika të shkurtra organizmin dhe funksionimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Foli për organet e AKK-së, Këshillin, Bordin dhe Administratën si dhe mekanizmat e AKK-së - Kolegjiemet të cilat janë rrjeta të drejtorëve apo zyrtarëve komunal të të gjitha Komunave të Kosovës. Në veçanti shprehi falënderim për bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha ministritë, sidomos me zyrën ligjore të Zyrës së Kryeministrit për përfshirjen e AKK-së në të gjitha grupet punuese në hartimin dhe shqyrtimin e projektligjeve që kishin të bënin me përgjegjësitë e Komunave të Kosovës.

Besim Kajtazi -Drejtor i Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, i cili falënderoi AKK-në për organizimin e takimit të përbashkët dhe foli për bashkëpunimin shumë të mirë gjatë vitit 2010, po ashtu shprehi shpresën se që bashkëpunim të jetë i njëjtë edhe gjatë vitit 2011. Gjatë vitit 2010 në Strategjinë Legjislative kanë qenë të përcaktuara 124 projektligje, prej tyre 58 ishin të bartura nga vitit 2008 dhe 2009, 101 prej tyre janë hartuar, 59 projektligje janë aprovuar nga Qeveria, 58 prej tyre janë dërguar në Kuvend dhe 1 është ende në procedurë, 31 grupet punuese të formuara janë duke punuar në 34 projektligje të cilat janë në fazën përfundimtare. Në Qeveri janë nxjerrë, 7 rregullore, 9 udhëzime administrative dhe 1 urdhëresë administrative, pra gjithsej janë përgatitur 17 akte nënligjore. Gjatë këtij viti janë nxjerrë 5 ligje bazike që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e Komunave të Kosovës: Ligji për organizimin e administratës shtetërore; Ligji për shërbimin civil; Ligji për qasje në dokumentet zyrtare; Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale; Ligji për klasifikimin e informatave dhe rregullave të sigurisë. Ndërsa në këtë vit që po vjen do të hartohet Projektligji për nismat legjislative dhe në Strategjinë legjislative për vitin 2011 pritet të jenë 145



projektligje, 10 prej tyre ende janë diskutabile, 5 janë në diskutim- të cilët janë për mekanizmat e sigurisë, 130 do të hartohen gjatë vitit 2011 si dhe për veç tyre dhe 22 iu kanë kthyer Qeverisë nga Kuvendi. Për ta bërë gjithë këtë punë ftohen të gjithë të japin kontributin me qëllim që ligjet të jenë sa më të zbatueshme dhe pothuajse me hartimin e të gjitha këtyre ligjeve të arrihet qëllimi për shkëputjen përfundimtare nga rregulloret e UNMIK-ut dhe krijimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës.

z.Kajtazi ftoi zyrtarët komunal po edhe ata ministrorë për komunikim më të mirë dhe ftoi ata që t'i drejtohen ZKM-së për çfarëdo problemi që kanë nga fusha e infrastrukturës ligjore. Ai kërkoi nga pjesëmarrësit të japin rekomandime për Strategjinë Legjislative 2011, që të nxirren të gjitha aktet ligjore për lehtësimin e punëve nëpër komuna dhe ministri. Në këtë takim kanë diskutuar edhe përfaqësuesit: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) - z.Agron Maxhuni, Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) – z.Luzim Rafuna, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) – znj.Leunora Kryeziu, Zv.Kryesuesi i Kolegjiemit për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale – z.Bashkim Hyseni, Ministria e Transportit dhe Postë-telekomunikacionit (MTPT) – z.Avdi Kamerolli, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) – z.Naim Shala, Ministria e Integritimeve Evropiane (MIE) – z.Rexhep Bllaca, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) – z.Remzush Latifi, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe

Teknologjisë (MASHT) – z.Hysni Kryeziu, Ministria e Kulturës, Rinisë e Sporteve (MKRS) – z.Sadik Kryeziu, Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) – z.Hakif Jashari, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) – z.Shefki Zeqiri, Ministria e Drejtësisë (MD) – z.Alban Syla, Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) – z.Nuhi Uka si dhe Znj.Qazime Vata – Kryesuese e Kolegjiut për Planifikim hapësinor, znj.Aferdita Grapci – Kryesuese e Kolegjiut për Buxhet dhe Financa, z.Xhemë Binaku – Kryesues i Kolegjiut për Administratë, z.Agim Haziri – zv.Kryesues i Kolegjiut për Shërbime Publike, z.Bashkim Hyseni- zv.Kryesues i Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z.Bajram Beqiri – Kryesues i Kolegjiut për Inspeksion, z.Qerim Selimi – zv.Kryesues i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë, z.Agim Salihu- Kryesues i Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor z.Shaqir Mala – Kryesues i Kolegjiut për Integrimi Evropiane dhe z.Shpetim Reznici – Kryesues i Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik.

Përfaqësuesit e komunave dhe drejtori i departamentit Ligjor të MAPL-së z.Agron Maxhuni shprehën pakënaqësinë për ri-centralizimin e disa kompetencave nga niveli lokal në nivelin qendror dhe kërkuan që të diskutohen ajo çështje para se të merren vendimi për të.

Në Strategjinë Legjislative për vitin 2011 të Ministrive të Linjës, projektligjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e Komunave janë:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL
Plotësim-ndryshimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ;
Projektligji për bashkëpunim ndër-komunal;
Projektligji për qytetin e Prishtinës;
Projektligji për referendum lokal;

Ministria e Ekonomisë dhe Financave - MEF
Projektligji për buxhetin për vitin 2011;
Plotësim-ndryshimi i Ligjit për ndërmarrjet publike;

Ministria për Punë dhe Mirëqenje Sociale - MPMS
Projektligji për skemën sociale;
Projektligji për strehimoren sociab-familjare;
Udhëzim administrativ për rregullimin e çështjes në rast të vdekjes e pensionistëve dhe rasteve sociale në bashkëpunim me MAPL-në;

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit – MTPK
Projektligji për adresat;
Plotësim-ndryshimi i ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor;
Projektligji për hekurudhat;

Ministria e Punëve të Brendshme – MPB
Plotësim-ndryshimi i Projektligjit për gjendjen civile;
Plotësim-ndryshimi i Projektligjit për letërnjoftimin;
Plotësim-ndryshimi i Projektligjit për Shërbimin Zjarrfikësve;
Plotësim-ndryshimi i Projektligjit për fatkeqësitë naty-

rore dhe fatkeqësitë tjera;

Ministria e Integrimi Evropiane - MIE
Harmonizimi i të gjitha Projektligjeve me legjislacionin e BE-së;

Finalizimi i shqyrtimit të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e zyrave për zyrtarët për integrimi evropiane;

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – MMPH

Projektligji për mbeturinat;
Projektligji për ndërtim;
Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje;
Akte nënligjore për zbatimin e ligjeve;

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë – MASHT

Projektligji për arsimin para-universitar;
Projektligji për arsimin e lartë;

Ministria e Kulturës, Rinisë e Sporteve – MKRS

Projektligji për teatrin;
Projektligji për bibliotekat;

Ministria e Energjetikës dhe Minierave- MEM

18 akte nënligjore për zbatimin e ligjit për minierat, disa kanë të bëjnë me komunat;

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – MBPZHR

Projektligji për pyje;

Ministria e Drejtësisë – MD

Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit për ushtrimin e detyrës për stafin politik.

KONKLuzionet:

- Bashkëpunimi mes Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Departamenteve Ligjore të Ministrive të Linjës dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës për vitin 2011 të vazhdojë në frymën e njëjtë si gjatë vitit 2010;
- Në mbledhjet e rregullta një mujore të Departamenteve Ligjore të ftohet edhe AKK-ja të merr pjesë -zyrtarja Ligjore;
- Aktet nënligjore të Ministrive të Linjës të cilat duhet të zbatohen nëpër Komuna, duhet të jenë në harmoni me ligjet në fuqi, dhe gjatë hartimit të tyre të marrin pjesë edhe zyrtarët komunal;
- Gjatë procesit të bartjes së kompetencave në autoritet lokale të barten edhe financat ;
- Ministrinë të cilat do të organizojnë trajnime për zyrtarët komunal të bashkëpunojnë me AKK-në, për organizimin e trajnimeve;
- Prioritetet e Kolegjiut të AKK-së si dhe iniciativat për hartimin, ndryshim plotësim të legjislacionit t'i drejtohen Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

PREZANTOHET RAPORTI PËR BASHKËPUMIN-NDËRKOMUNAL NË KOSOVË

Me datën 02 Nëntor 2010 Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me UNDP-në organizoi në restau-rant "VILA GËRMIA" në Prishtinë takim të rreth Bashkëpunimit Ndër-Komunal në Kosovë. Në takim morën pjesë drejtore të Drejtorive Komunale të Shërbimeve Publike, Bujqësisë e Pylltarisë dhe të atyre të Inspeksionit si dhe përfaqësues të UNDP-së e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z.Sazan Ibrahim hapi takimin dhe falënderoi të gjithë Drejtorët e Drejtorive si dhe përfaqësuesit e UNDP-së për pjesëmarrje, ku edhe përmendi rëndësinë e angazhimit për një Bashkëpunim Ndër-Komunal në Kosovë. Asociacioni i Komunave të Kosovës ka analizuar situatën aktuale të Bashkëpunimit Ndërkomunal në Kosovë dhe perspektivën për të ardhmen. Ky studim vë nevojat dhe prioritetet sipas formimit dhe sfidave të bashkëpunimit ndërkomunal, AKK-ja ka për qëllim të rris BNK-në në mes komunave të Kosovës, si dhe angazhimin e komunave në projektet e reja të cilat do të financohen nga UNDP-ja në fusha të ndryshme. Diskutimi në vazhdim do të jetë i hapur për çdo sugjerim dhe vërejtje.

Znj. Rreze Duli- Projekt Menaxhere (UNDP)- në fjalën e saj tregoi për rëndësinë e madhe të bashkëpunimit në mes të komunave në projekte të

Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i raportit për bashkëpunim-ndërkomunal dhe informimi i drejtorëve për rëndësinë e këtij projekti në ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe zhvillimit lokal në të ardhmen, përpilimin si dhe financimin e projekteve të reja nga ana e UNDP-së. Një ndër pikat e diskutimit janë edhe praktikatat e mira të bashkëpunimit ndër-komunal në shumë fusha të ndryshme si në rrugë, menaxhim të mbeturinave, menaxhimi i pyjeve si dhe mbrojtjen e tyre, ujërat e zeza etj. Gjithashtu pengesat në fushën e bashkëpunimit dhe obligimet e palëve në përmirësimin e marrëdhënieve të mëtutjeshme në të ardhmen.

ndryshme në të mirë të qytetarëve. UNDP-ja është e gatshme jo vetëm të ofrojë ndihmë financiare për projektet e reja por edhe ofrimin e mbi 50 praktikave të reja të vendeve të rajonit e më gjerë si Maqedonia, Shqipëria, Armenia etj. si dhe adaptimi i udhërrëfyesit si dhe hapat drejt një bashkëpunimi të tillë. Po ashtu ceku se është duke u punuar në projektligjin për BNK-në ku janë në pritje deri tek procedimi dhe aprovimi në Parlament.

Ismet Hajdini-Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit (Gjilan) – ku tregoi se ekziston bashkëpunimi me komunat tjera si të Novobërdës, sikurse edhe trajnimi i inspektorëve të Parteshit. Bashkëpunimi nuk mungon edhe në operimin e inspektorëve komunal në komunat tjera si të Parteshit dhe Novobërdës. Mirëpo gjithmonë në bazë të një mirëkuptimi të dy palëve.

Nazmi Rapuca-Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë (Gjilan)- duke vazhduar me diskutimin, tregoi për bashkëpunimin me komunat tjera në pastrimin e mbeturi-

nave apo mbrojtjen e pyjeve në raste zjarri. Në mungesë të kapaciteteve të komunave të reja inspektorët tanë mbulojnë edhe ato zona. Gjithashtu jemi në bisedime me Komunën e Novobërdës për investim të përbashkët në një teren për rekreacion sikurse në Prevallë ku gjithashtu kërkojmë edhe bashkëpunimin e popullatës për çështjen konkrete.

Hasan Rashiti- Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë (Kllokot)- tregoi për vështirësitë që mund të hasin në fillim për bashkëpunim me komunat tjera në punën e tyre, po ashtu ceku përvojat e mira me Komunën e Vitisë në përkrahjen e tyre me dokumentacionin civil dhe atë të kadastrës, po ashtu përmendi edhe punën e përbashkët në pastrimin e lumenjve të Binçes dhe Moravës në parandalimin e vërshimeve të reja në komunë dhe rajon.

Sazan Ibrahim-Drejtor Ekzekutiv (AKK) – duke u ndërlidhë në vazhdim të diskutimeve, sugjeroi një këshillë se do të ishte mirë nëse do të ketë participim të përbashkët edhe

nga komnat ,në financimin e projekteve të reja. Agim Haziri- Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike (Viti)– tregoi se bashkëpunimi ndër-komunal ekziston vetëm në formë private apo gojore, andaj edhe propozoi të ketë një bashkëpunim në formë zyrtare që ajo të jetë me shkrim. Po ashtu sugjeroi të ketë një bashkëpunim në financimin e projekteve me donator të ndryshëm ku edhe do të kenë përgjegjësinë edhe për efektivitetin e projekteve të ndryshme.

Nasuf Aliu-Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë (Vushtri)– tregoi se si në praktikë drejtorët hasin në probleme me bashkëpunimin në mes të komunave për çështje të përbashkëta siç është ajo e mbrojtjes së pyjeve. Kjo situatë sipas tij duhet të rregullohet me marrëveshje zyrtare e mirëkuptim në mes të palëve në proces. Rreze Duli nga UNDP-ja- sugjeroi se nëse ka projekte të gatshme UNDP- ja është e gatshme të rrisë fondet për financimin e projekteve të reja.

Behar Mehmeti- Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike (Gjilan)- tregoi se komnat duhet të jenë participuese në projektet e ardhshme si dhe përgjegjëse në mbarëvajtjen dhe ecurinë e projekteve të cilat marrin pjesë. Me komnat tjera nuk kemi marrëveshje, dhe me këtë rast duhet të kemi një memorandum për bashkëpunim mes komunave në projektet e reja.

Rufat Shkreta Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike (Hani i Elezit) -kemi bashkëpunim me komnat tjera por jo marrëveshje zyrtare si në menaxhimin e pyjeve, mbeturi-



nave, ujërave të zeza. Një ndër projektet e rëndësishme është edhe ai i impiantit të ri. Sazan Ibrahim- Drejtor Ekzekutiv (AKK) - është një ide e qëlluar për hartimin e projekteve të reja në mënyrë të përbashkët, këto forma gjithsesi do të jenë shumë të efektshme për BNK-të, ndërsa për impiantin projektet do të duhen të dorëzohen në Komisionin Evropian ku ka më tepër fonde. Nasuf Aliu- Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë (Vushtrri) - me Komisionin Evropian kemi biseduar për

projekte të reja, mirëpo gjatë diskutimit me MAPL na kanë sugjeruar se impiantet janë problem nacional dhe se do të rregullohen nga nivelet më të larta qeveritare.

Fexhri Hyseni- Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë (Pristinë) – tregoi për bashkëpunimin me komnat tjera në fushë të ndryshme si në pronë e kadastër. Po ashtu tregoi se zyra ligjore është duke punuar në harmonizimin e akteve ligjore, ku një ndihmesë e madhe është edhe udhërrëfyesi, sikurse edhe puna e mirë që është duke u bërë në draftimin e ligjit të ri për BNK në Qeverinë e Kosovës . Sazan Ibrahim-Drejtor Ekzekutiv (AKK) – në fjalën përmbledhëse tha se “dolën disa ide të mira, dhe besoj se do të kemi bashkëpunim për tejkalimin e pengesave në fusha të ndryshme si mbrojtja e pyjeve ku kemi biseduar dhe do të bisedojmë edhe në të ardhmen me Ministrat e Bujqësisë dhe Financave për problemet specifike të cilat ju me të drejtë i cekët. Gjithashtu ju ftoj të merrni pjesë në hartimin e projekteve të ardhshme për financim nga UNDP-ja”.

REKOMANDIMET:

- Aprovimi i projektligjit për bashkëpunim ndër-komunal;
- Marrëveshje zyrtare për bashkëpunimin ndër-komunal në sfera të ndryshme si menaxhimi i pyjeve, ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave, rrugëve, etj.;
- Përpilimi i projekteve në mënyrë të përbashkët për financim nga donatorët.

Qeveritë Lokale në Evropën Juglindore kërkojnë rol më të madh në procesin e pranimet në BE

Presidentja e Komitetit të Rajoneve znj. Mercedes Bresso u takua me Presidentin e Rrjetit të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) Vladimir Moskov për të përforcuar rolin e autoriteteve lokale në procesin e pranimet në BE. Ata bënë thirrje për Komisionin Evropian për t'i njohur qeveritë lokale si aktorët kryesor në programimin dhe shfrytëzimin e fondeve të para-pranimet në BE (IPA), sidomos në prag të ciklit të ardhshëm të IPA programimit për periudhën 2013-2018 dhe më gjerë.

KE-ja ka filluar një proces konsultimi për të përmirësuar IPA-at, duke qenë instrumenti kryesor i fondeve të para-pranimet. Kjo është parë nga NALAS-it si një mundësi për të vënë në praktikë parimin e qeverisjes shumë-nivelesh, ku të gjitha nivelet e qeverisë do të ndajnë përgjegjësitë për të maksimizuar dhe përshpejtuar reformat në këtë pjesë të Evropës.

Presidenti Bresso përshëndeti zgjerimin e Marrëveshjes së Kryetarëve në Ballkanin Perëndimor e cila ishte shpallur më parë nëpërmjet një deklarate të përbashkët të miratuar nga të gjithë Presidentët e katërmëdhjetë (14) asociacioneve anëtare të NALAS-it, e miratuar nga Këshilli Evropian i Komunave dhe Regjioneve (CEMR), Qytetet të Energjisë dhe Fondacioni Evropian për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Rajoneve (FEDRE), me mbështetjen e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (CLRA). Marrëveshja e Kryetarëve është konsideruar si një nga nismat më të fuqishmet të ndërmarra nga autoritetet lokale dhe rajonale, duke mobilizuar më shumë se 2000 autoritete lokale nga 42 vende. Nëpërmjet kësaj



nisme, qeveritë lokale nga EIL-ja janë gjithashtu të etur për të shkuar përtej objektivave të energjisë dhe të klimës së BE-së, megjithatë, ndihmat teknike dhe mekanizma të duhur financiare janë të domosdoshme për të përmbyshur pritjet.

Presidentët Bresso dhe Moskov gjithashtu e njohën rolin pozitiv të Komisioneve konsultative të përbashkëta të KR-së dhe Grupet Punuese, dhe shprehen angazhim të fortë të eksplorojnë më tej format e tjera të bashkëpunimit në mes të KR-së dhe NALAS-it në mënyrë që të forcojë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e

qeverive lokale në përgatitjet për hyrjen në BE. Për më tepër përvoja e decentralizimit në Evropën Juglindore është parë edhe si një burim i vlefshëm për zgjerimin e partneritetit lindor evropian.

NALAS-it është themeluar në kuadër të Paktit të Stabilitetit dhe me mbështetje të Këshillit të Evropës. Misioni i saj është të inkurajojë procesin e decentralizimit në Evropën Juglindore nëpërmjet forcimit dhe lidhjes së Asociacioneve të Pushtetit Lokal dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në demokracinë dhe stabilitetin në rajon, dhe më pas të shpejtoj dhe me sukses integrimin në BE.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti VII, Nr. 45 • Nëntor - Dhjetor 2010

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

